



Raporti i vitit 2021

Janar 01- 31.01.2021

1. Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave

Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave gjatë muajit janar, 2021, ka kryer këto aktivitete: Kërkesat për hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimin e nevojave, shqyrtimin e kërkesave të banorëve të bashkësive lokale dhe inkorporimi i tyre në planet e Komunës, njoftimi me kohë i kompanive publike dhe subjekteve relevante, me qëllim të koordinimit të punëve, incizimi i gjendjes ekzistuese të infrastrukturës në qytetin e Prishtinës, si dhe kompletimi i dokumentacionit teknik për procedimin e tyre në organet kompetente, mbikëqyrja e realizimit të projekteve konform marrëveshjes etj.

1.1. Shqyrtimi i kërkesave

Gjatë muajit janar drejtoria ka proceduar 79 kërkesa të ndryshme të bashkësive lokale dhe qytetarëve: për ndërtimin e rrugëve, trotuareve dhe kanalizimeve, kërkesa për rregullimin e rrugëve dhe kanalizimeve, kërkesa nga kompanitë publike-leje për gropim dhe intervenime për sanimin e defekteve të ndryshme, kërkesa nga kompanitë për formime të komisioneve për kontrollimin e punëve, kërkesa të natyrave të ndryshme rreth definimit të zgjidhjes në terren etj. Nga numri i përgjithshëm prej 79 kërkesave të pranuar, 72 kërkesa janë të përfunduara.

1.2. Dërgimi i kërkesave për hartimin e detyrave projektuese dhe identifikimi i nevojave

Duke marrë për bazë Ligjin mbi planifikimin hapësinorë, Ligjin mbi ndërtimin e objekteve investive, si dhe Ligjin për projektim, e në veçanti planet rregulluese, janë dërguar kërkesat për hartimin e detyrave projektuese në zonat urbane dhe rurale.



1.3. Raportimi i menaxherëve të projekteve infrastrukturore

Drejtoria	Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave
Sektori	Menaxhimi i Kontratave (Ndërtimi i ulët)
Drejtori	Gëzim Mehmeti
Raportoi	Dukagjin Buqaj, idn., u.d. i shefit të Sektorit
Kontrolloi – Përpunoi	Muhamed Emra, idn, zyrtar i lartë për ndërtim urban
Periudha raportuese	01-31.01.2020, muaji janar, 2021
Menaxhëret e projekteve	Muhamed Emra Irfete Zejneli Syzana Pllana Qazim Bajrami Dugagjin Buqaj Ibrahim Gervalla Zyhrije Pllana
Organi mbikqyrës	Azem Buzuku Aferdita Sopi Behxhet Gashi Ramadan Nebiu Hazir Krasniqi Amire Krasniqi Bujar Rama

1.3. Raportimi i menaxherëve të projekteve Infrastrukturore

- Tash për tash nuk janë duke zhvilluar punimet në asnjë kontratë, për shkakë të motit të lig - kushteve atmosferike të sezonit dimëror.

Drejtori :
Gëzim Mehmeti

Prishtinë, janar 2021